

V E N D I M
Nr.31, datë 18.7.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Manol Konomi,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtar i
Franc Jakova,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datat 8.7.1996 dhe 15.7.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.35 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S : ISMET BEQIRI

O B J E K T I :

Shfuqizimi i Dekretit nr.1488, datë 15.5.1996 të Presidentit të Republikës.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Mbi propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Presidenti i Republikës me Dekretin nr.1488, datë 15.5.1996 e ka shkarkuar nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Ballshit kërkuesin Ismet Beqiri për shkelje të rënda të ligjit.

Në propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave bazuar në kërkesën e Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal nr.2154, datë 9.5.1996 parashtrohet :

1. Kryetari i Bashkisë së Ballshit, Ismet Beqiri ka kryer shkelje flagrante të neneve 21 e 32 të Ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”;

2. “... Drejtuesit e Bashkisë Ballsh kanë vepruar në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.162, datë 18.3.1996 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.14, datë 24.1.1994 “Për ndryshimin e vendbanimit nga shtetasit shqiptarë”, duke penguar regjistrimin e qytetarëve që kërkojnë ligjërisht evidentimin e tyre pranë gjendjes civile të qytetit të Ballshit”.

Gjykata Kushtetuese, duke u mbështetur në provat e administruara arrin në përfundimin se Propozimi për shkarkimin e Ismet Beqirit i bërë nga Këshilli i Ministrave nuk mbështetet në ligj e në fakt e si pasojë Dekreti i nxjerrë mbi këtë bazë duhet të shfuqizohet.

1. As në kërkesën e Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal dhe as në propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave nuk tregohet se ku konsistojnë shkeljet e neneve 21 e 32 të Ligjit “Për zgjedhjet”.

Në shkresën e sipërme Prefekti i Fierit ngre si shkelje të rëndë të ligjit nga ana e kryetarit të Bashkisë “kundërshtimin e hapur për përcaktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit në ambientet e propozuara...”.

Nga përmbajtja e shkresës nr.132, datë 25.4.1996, e kryetarit të Bashkisë del se i ka komunikuar komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.84 dhe për dijeni Prefekturës, vendimin për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit. Prefekti nga ana e tij ka caktuar qendra të tjera votimi.

Kryetari i Bashkisë e ka kundërshtuar këtë veprim të Prefektit, duke iu drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr.3138, datë 1.5.1996, në të cilën ve në dukje se prefekti ndërhyr në kompetencat e bashkisë për krijimin e caktimin e qendrave të votimit. Përfundimisht qendrat e votimit mbeten ato të caktuara nga prefekti.

Në mbështetje të neneve 21 e 32 të Ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, caktimi i

vendndodhjes së qendrave të votimit është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë. Prefekti, në rastin konkret mund të propozonte, por mosmarrja parasysh e propozimeve nuk është shkelje e ligjit. Nëse prefekti nuk ishte dakord me vendimin e Bashkisë, ai kishte të drejtë që këtë vendim ta kundërshtonte në kohë, në rrugët e mënyrat e parashikuara nga neni 6 i Ligjit “Për Prefekturat”.

2. Këshilli i Bashkisë së Ballshit, më 16 mars 1995 ka marrë vendimin nr.20 “Për vendosje e ndryshim takse”, ku në pikën 2 është përcaktuar që taksa për marrje vendimi për leje banimi nga 500 lekë të bëhet 5.000 lekë.

Ky vendim, në bazë të Ligjit “Për Prefekturat”, i është dërguar Prefektit të Fierit, i cili me shkresën nr.369/1, datë 25.4.1995 njofton Këshillin e Bashkisë se vendimin e gjen në përputhje me ligjin dhe porositi që të vihej për zbatim.

Pas një viti nga fillimi i zbatimit të këtij vendimi, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile pranë Këshillit të Rrethit Mallakastër, me shkresën nr.261, datë 17.4.1996 dërguar Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal e Prefekturës shtron problemin se mbasi është dëgjuar në televizor një intervistë mbi heqjen e taksave për lëvizjen e

lirë të qytetarëve, për këtë çështje ka patur mjaft përplasje me shtetasit që kërkojnë të vijnë në qytet. Në përfundim në shkresë kërkohet nga këto organe se si duhet vepruar.

Prefekti i Fierit me shkresën nr.546/1, datë 30.4.1996 ve në dijeni Bashkinë Ballsh, ku thekson se vendimi për taksën prej 5.000 lekë nuk është në përputhje me ligjin e të mos zbatohet. Këshilli i Bashkisë mori në shqyrtim këtë shkresë të prefektit dhe me vendimin nr.36, datë 17.5.1996, la në fuqi vendimin e mëparshëm të tij për taksën për leje banimi. Prefekti ndonëse e quan këtë vendim të pambështetur në ligj nuk i drejtohet gjykatës, por me shkresën nr.755/1, datë 10.6.1996 urdhëron të moszbatohet, duke vepruar kështu në kundërshtim me kompetencat që i njeh Ligji “Për Prefekturat”.

Në kohën kur ende Këshilli Bashkiak nuk ishte shprehur për ligjshmërinë e vendimit të tij, bazuar në shkresën e përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile të rrethit, Sekretariati Shtetëror i Pushtetit Lokal, me shkresën nr.2154, datë 9.5.1996 drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave e paraqet problemin sikur drejtuesit e Bashkisë kanë vepruar në kundërshtim me vendimet e Këshillit të Ministrave nr.162, datë 18.3.1996 e nr.14, datë 24.1.1994 dhe kanë penguar regjistrimin e qytetarëve që kërkojnë ligjërisht evidentimin e tyre pranë gjendjes civile Ballsh.

Paraqitja në këtë mënyrë e problemit del e pabazuar jo vetëm nga parashtrimi i fakteve si më sipër, por për më tepër edhe sepse vendimet e lartpërmendura të Këshillit të Ministrave nuk bëjnë fjalë për taksat dhe nuk kanë përcaktuar ndonjë detyrë konkrete për Kryetarin e Bashkisë apo Këshillin Bashkiak, të cilat sipas Sekretariatit, qenkan shkelur apo është vepruar në kundërshtim me to.

I pyetur nga Gjykata, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile të rrethit shpjegoi se shkresën nuk e ka bërë për të denoncuar ndonjë shkelje, por për t’u sqaruar. Ai shtoi se nuk ka pasur pengesa për regjistrimin e qytetarëve në gjendjen civile.

Gjykata Kushtetuese, duke mos e pasur për objekt, nuk hyn në çmimin e ligjshmërisë së vendimit nr.20, datë 16.3.1995 të Këshillit Bashkiak. Megjithatë, Gjykata ve në dukje se si vendimi i mësipërm dhe ai me nr.36, datë 17.5.1996, janë marrë nga Këshilli Bashkiak me kryetar Nuredin Xhelilin e jo nga kërkuesi, e për pasojë edhe sikur të konsideroheshin të paligjshëm nuk mund të përbëjnë shkelje për Ismet Beqirin si Kryetar Bashkie.

Nga sa u parashtrua më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se shkeljet e ligjit që i atribuohen Ismet Beqirit në kërkesën e Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal dhe në propozimin e Këshillit të Ministrave, nuk qëndrojnë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 3 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

Shfuqizimin e Dekretit nr.1488, datë 15.5.1996.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më 18.7.1996

